



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 16, datë 21.05.2025

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT NR. 30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1032, RRUGA “ALEKS KOMNENI” DHE PALLATIN “KASTRATI”, RRUGA “RAMADAN VELIU”, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, TË NDRYSHUAR.

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 30, datë 26.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.1032,

rruga “Aleks Komneni” dhe pallatin “Kastrati”, rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, z. Muhamet Vata – numër rendor 13, Alban Tarelli + Irvana Tarelli – numër rendor 66, Lirim Murrja + Shadije Zili – numër rendor 60, Arber Babi – numër rendor 68, Algert Kurti – numër rendor 44, Petrit Dakavelli + Irma Dakavelli – numër rendor 31, dhe Eduart Matmuja + Blerina Matmuja – numër rendor 76.

2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1, bashkëlidhur Vendimit nr. 76, datë 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i procesit të rindërtimit për pallatin “Kastrati”, rruga “Ramadan Veliu”, pallati nr.458, rruga “Bajram Tusha”, si dhe pallati nr.1062, rruga “26 Nëntori”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, Mentor Muja – numër rendor 8, Dajana Lumi – numër rendor 3, Avni Shahu – numër rendor 12, Arjan Onuzi – numër rendor 13, Aziz Isufaj + Fllanxa Isufaj – numër rendor 15, dhe Arti Mancka – numër rendor 16.
3. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 120, datë 30.09.2021 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 2, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021, përsa i përket listës së përfituesve që do të përfitojë nga Programi i procesit të rindërtimit për pallatin “Kastrati” rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, Dode Nikollaj + Marjana Nikollaj – numër rendor 80, Astrit Murati – numër rendor 79, Ilia Traja + Merita Traja – numër rendor 92.
4. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 143, datë 12.11.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve në aneksin 2, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021, përsa i përket listës së përfituesve që do të përfitojë nga Programi i procesit të rindërtimit për pallatin “Kastrati” rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, Altin Kovaci – numër rendor 102, dhe Erta Spaho – numër rendor 103.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 22.05.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 351 prot.
3

Durrës, më 28.05.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës
KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 16 datë 21.05.2025 “Për miratimin e ndryshimit të vendimit nr 30 datë 26.03.2021 “ Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 1032, Rruga Aleks Komneni dhe pallatin Kastrati Rruga Ramadan Veliu, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 i ndryshuar”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

